



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

---

**V E N D I M**  
**Nr. 49, datë 24.06.2019**

**PËR SHITESË PLANI NË BUXHETIN E BASHKISË SHKODËR NË SHUMËN**  
**88,000 LEKË**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 24.6.2019, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 35 pika 1, gërma “d“, neni 54 gërma “dh“, 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“; neni 20, pika 1 dhe 5 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore“; ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar; pika 101 dhe 109/h e udhëzimit nr.9, datë 20.03. 2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit“, Udhëzimit plotësues nr. 1 datë 17.01.2019 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019“, ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë“, ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës“, ligjit nr. 8788 datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse“, i ndryshuar, VKM nr. 148 datë 13.3.2018 “Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit, ndërmjet mekanizmave këshëllimorë e koordinues institucional, strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave kombetare e vendore si dhe për shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës“, ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë“, Urdhrit të përbashkët për miratimin e Rregullores ndërmjet 3 Ministrive që përcakton procedurat, detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve shtetërore për zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet tri ministrive, protokolluar në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) me nr. 7522 prot., datë 12.07.2018, në Ministrinë e Brendshme (MB) me nr. 8649 prot., datë 22.10.2018 dhe në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) me nr. 6084 prot., datë 23.10.2018, “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor“, Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe Observatori për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve, nr. Prot. 5750 datë 08.04.2019; VKB nr. 82 datë 20.12.2018 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2019 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2019-2021 të Bashkisë Shkodër“, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga administrata e Bashkisë,

## V E N D O S I:

1. Miratimin e shtesës së planit të buxhetit të Bashkisë Shkodër, shuma **88.000 lekë** (*tetëdhjetë e tetë mijë*), brenda llogarisë së thesarit, në programin 10430 “Kujdesi social për familjet dhe fëmijën“, që në kuadër të projektit “Çdo fëmijë në shkollë”, mbështetur nga UNICEF dhe që zbatohet nga “Observatori për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve”, i jepet Bashkisë së Shkodrës për mbështetjen e 2 rasteve të fëmijëve të identifikuar jashtë sistemit arsimor, me qëllim integrimin e tyre në shkollë, për vitin shkollor 2019-2020.

Shpenzimet e llogaritura						
Shpenzimet për çdo aktivitet	Totali ( lekë)	Nga kjo:				
		Paga	Sigurime	Shpenzime Operative	Transferime	kapitale
Shuma 2019	<b>40.000</b>			40.000		
Shuma 2020	<b>48.000</b>			48.000		
<b>Shuma</b>	<b>88.000</b>					

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 24.6.2019

Shpallur në datën 25.6.2019

**Sekretar i këshillit**

**K R Y E T A R**

**Suel Hadri**

**Xhemal BUSHATI**